

## DEKLARATË PUBLIKE

### E RRJETIT "PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE" NË LIDHJE ME ZGJEDHJET LOKALE TË 14 MAJIT 2023

**Tiranë, më 19 Maj 2023.**

Rrjeti Përballja e Ofertave Politike (**Rrjeti POP**) është një nismë e 12 organizatave lokale të shoqërisë civile, të pavarura, të cilat synojnë të rrisin debatin publik dhe informacionin te qytetarët gjatë periudhave zgjedhore, si dhe orientimin e platformave politike drejt nevojave dhe prioritetëve të qytetarëve.

Në muajt e parë të vitit 2023, Rrjeti POP krijoi një platformë të hapur dhe të pavarur, ku rreth 1000 qytetarë nga zonat rurale dhe urbane (në bashkitë Tiranë, Durrës, Vlorë, Fier, Kukës, Shkodër, Vau i Dejës, Pukë, Elbasan dhe Korçë) diskutuan mbi nevojat dhe prioritetet e tyre në 62 tryeza diskutimi. Prioritetet e qytetarëve të secilës bashki u pasqyruan në **10 (dhjetë) Kontrata Sociale**<sup>1</sup>. Kontratat Sociale u bazuan në katër fusha kryesore: (i) Demokracia Vendore dhe Mirëqeverisja; (ii) Drejtësia Sociale; (iii) Zhvillimi Ekonomik Vendor; (IV) Infrastruktura dhe Shërbimet Publike.

Pas hartimit të Kontratave Sociale, të gjitha partitë politike dhe kandidatët e tyre në 10 bashki të vendit, morën ftesë të merrnin pjesë në forumet publike të Rrjetit POP. Forumet publike që organizohen në kuadër të zgjedhjeve vendore 2023 kanë për qëllim të nxisin kulturën demokratike dhe synojnë të sigurojnë një hapësirë të hapur dhe të barabartë për përfaqësuesit e partive politike për të paraqitur platformat e tyre dhe për të diskutuar me qytetarët mbi Kontratat Sociale dhe shqetësimet e tyre.

Megjithë përpjekjet e anëtarëve të Rrjetit POP, jo të gjitha partitë politike shqiptare patën vullnetin politik për të realizuar përballje mes kandidatëve për kryetarë bashkie. Në këto kushte Rrjeti POP, vazhdoi misionin e tij, duke mundësuar forume individuale mes qytetarëve dhe kandidatëve për kryetarë bashkie që përfaqësonin forcat më të mëdha politike në vend, duke vënë në plan të parë interesat e qytetarëve dhe adresimin e problemeve të tyre të cilat kërkojnë vëmendje të shtuar.

Gjatë periudhës prill-maj 2023, **Rrjeti POP organizoi 16 forume publike në nëntë bashki**,<sup>2</sup> ku kandidatët/et për kryetarë/e bashkie diskutuan mbi prioritetet qytetare të Kontratës Sociale. **Pesëmbëdhjetë (15) Kontrata Sociale u firmosën nga kandidatët si një angazhim moral i tyre për të adresuar prioritetet e qytetarëve.** Përmes realizimit të forumeve publike për Kontratat Sociale, rrjeti POP tregoi që është i vetmi rrjet organizatash lokale që arriti të vendosë kandidatët për kryetarë bashkie përballë qytetarëve, me qëllim që prioritetet e qytetarëve të adresohen në axhendat e të zgjedhurve vendorë. Aktivitetet e POP 2023 ishin ndër të vetmet aktivitete ku qytetarët gjetën një mjedis të lirë nga politika dhe patën mundësi të shprehen në lidhje me shqetësimet e tyre në nivel vendor.

<sup>1</sup> Faqe zyrtare e Rrjetit POP: <https://popnetwork.al/kontratat-sociale-2023-2027/>

<sup>2</sup> Forumet u organizuan me 6 (gjashtë) kandidatë të Partisë Socialiste që garuan në zgjedhjet për kryetar bashkie në Shkodër, Durrës, Vau i Dejës, Korçë, Kukës dhe Vlorë; 8 (tetë) kandidatë nga Koalicioni "Bashkë Fitojmë" që garuan në zgjedhjet për kryetar bashkie në Tiranë, Fier, Durrës, Shkodër, Pukë, Kukës, Vau i Dejës dhe Vlorë si dhe 2 (dy) kandidatë të Partisë Demokratike të Shqipërisë në Tiranë dhe Vau i Dejës, nga 3 kandidatë që garonin gjithsej nga kjo forcë politike në 10 bashkitë ku vepronë organizatat e rrjetit POP.

Realizimi i forumeve dhe nënshkrimi i Kontratave Sociale është vetëm hapi i parë i procesit: Gjatë katër viteve të ardhshme, bashkitë do të monitorohen nga organizatat e Rrjetit POP mbi progresin e realizimit të prioritetëve të identifikuar nga qytetarët.

### **Opinioni i Rrjetit POP mbi forumet publike në zgjedhjet vendore të 14 Majit 2023**

Nga e gjithë puna që anëtarët e Rrjetit POP realizuan, më poshtë janë disa çështje kryesore që u vunë re gjatë periudhës së fushatës elektorale të zgjedhjeve vendore të 14 Majit 2023:

- Në forumet publike me kandidatët të organizuara nga Rrjeti POP, u vërejt se një pjesë e madhe e kandidatëve nuk kishin programe apo plane lokale të qarta dhe transparente, që do të mund të adresonin problematikat e qytetarëve. Programet e kandidatëve për kryetarë bashkie ishin minimaliste, të reduktuara në fletpalosje me pika programore. Gjatë fushatës u vërejt mungesë e retorikës së thelluar sa i përket financave të pushtetit vendor dhe mënyrave për të siguruar mbështetje për prioritetet e qytetarëve. Diskursi politik i kandidatëve dhe përfaqësuesve të partive nuk përfshinte gjithmonë grupet e marginalizuara dhe integrimin e tyre në nivel lokal apo të rinjtë, gratë dhe vajzat. Rrjeti POP nëpërmjet Kontratave Sociale kontribuoi drejtpërdrejt në mbushjen e hendekut mes ofertës programore të kandidatëve dhe nevojave të qytetarëve.
- Megjithë angazhimin pozitiv të pjesës më të madhe të kandidatëve, katër forume publike nuk u realizuan përpara Ditës së Zgjedhjeve si pasojë e mungesës së vullnetit të kandidatëve. Megjithatë, kandidatët vlerësuan rëndësinë e këtij formati të diskutimit dhe premtuan që, nëse fitonin zgjedhjet, do të angazhoheshin për nënshkrimin e Kontratës Sociale dhe ndërthurjen e prioritetëve të qytetarëve në planet e punës të tyre për katër vite.
- Siç konstatohet edhe nga raporti i OSBE/ODIHR fushata zgjedhore u zhvillua në një mjedis mediatik të karakterizuar nga disa probleme sistematike që ndikojnë në lirinë e medias dhe gazetarinë.<sup>3</sup> Qasja alternative e rrjetit POP për publikimin e forumeve publike online në faqen zyrtare në Facebook<sup>4</sup>, duke i dhënë mundësinë të gjithë të interesuarve për ti ndjekur ato në kohë reale, si dhe mundësia që iu dha pjesëmarrësve në këto forume për të bashkëbiseduar me kandidatët, rriti interesin e pjesëmarrësve dhe ndihmoi në rritjen e transparencës dhe përfshirjes së qytetarëve në procesin zgjedhor. Një numër i konsiderueshëm qytetarësh ndoqën online debatet publike. Nga ana tjetër u vërejt një tendencë pozitive nga disa kandidatë që morën pjesë në forumet publike, të cilët ndanë në mediat e tyre sociale forumet, duke u mundësuar qytetarëve më tepër informacion rreth programeve të tyre.
- Në të gjitha forumet publike të organizuara, të gjithë kandidatët që morën pjesë ishin të vendosur që të nënshkruanin Kontratën Sociale dhe prioritetet e përcaktuara nga qytetarët dhe ta pranojnë atë si pjesë integrale të programit të tyre qeverisës, nëse ata do të fitonin zgjedhjet. Ata shprehën dëshirën e tyre për të siguruar se ato nuk do të jenë thjesht premtime elektorale, por do të jenë pjesë e një plani konkret për të arritur qëllimet e përcaktuara nga qytetarët.

<sup>3</sup> OSCE ODIHR, 2023 Deklarata e gjetjeve dhe konkluzioneve paraprake. Misioni Ndërkombëtar i Vëzhgimit të Zgjedhjeve Vendore, 14 maj 2023, faqe 14.

<sup>4</sup> <https://www.facebook.com/POPNetworkAlbania>. Forumet publike të realizuara nga Rrjeti POP dhe të shfaqura LIVE në Facebook arritën 74778 ndjekës të cilët u angazhuan në 9233 raste.

Rrjeti POP do të vazhdojë të jetë aktiv në nivel vendor për të përcjellë shqetësimet e qytetarëve të cilët kanë nevojë për ura lidhëse me pushtetin vendor. Njëkohësisht, Rrjeti POP do të monitorojë realizimin e Kontratave Sociale të nënshkruara dhe do të nënshkruajë kontrata sociale aty ku nuk mund të realizoheshin gjatë fushatës zgjedhore.

\*\*\*

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga “Olof Palme International Center” dhe “National Endowment for Democracy.”

Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra “Aleanca Gjimore për Zhvillim”, Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorë,
- Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz;
- Qendra “Epoka e Re”, Fier;
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës,
- Rinia për Integrim, Aktivizim, Pogradec;
- Gruaja në Zhvillim, Korçë;
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;
- Tjetër Vizion, Elbasan

Për më shumë informacion:

<https://www.facebook.com/POPNetworkAlbania>  
[www.popnetwork.al](http://www.popnetwork.al)